



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 17.10.2019)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:20 dhe mbaroi në orën 11:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
2. ***Medi Bici*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
5. ***Ilir Toska*** (anëtar)
6. ***Alban Toro*** (anëtar)
7. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
8. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje ***zonja Naureda Llagami***, Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***zoti Erjon Muharremaj***, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor si dhe ***zonja Brunilda Kadi***, anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
4. *Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
5. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
6. *Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
7. *Arlind Maloku, Qendra Evropiane.*
8. *Ervin Karamuço, ISP.*
9. *Julinda Beqiraj, EURALIUS.*
10. *Klodian Rado, EURALIUS.*
11. *Valbona Bala, USAID.*
12. *Gregor Borkowski, EURALIUS.*
13. *Chuck Ericksen, USAID.*
14. *Tahir Lamçe, OSCE.*

RENDI I DITËS:

1. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Maksim Qoku: Atëherë, përshëndetje të gjithëve!

Vijojmë sot me mbledhjen e radhës. Në mbledhjen e sotme nuk ndodhet Kryetarja zonja Naureda Llagami dhe dy anëtarët, përkatësisht Brunilda Kadi dhe zoti Erjon Muharremaj, pasi janë përfaqësues të Këshillit në angazhimet ndërkombëtare të Këshillit në organizmat ndërkombëtarë. Në bazë të ligjit për Qeverisjen, meqë bëhet kuorumi 7 anëtarë, mund të procedojmë me axhendën e radhës.

Sot është parashikuar një axhendë me 3 çështje kryesore.

Pika e parë: Caktimi i gjyqtarëve në gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Pika e dytë: Miratimi i projektvendimit “Për ndryshimin e vendimit nr. 211, datë 11.10.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për caktim gjyqtari, në një çështje gjyqësore të veçantë, në Gjykatën e Apelit Durrës””.

Dhe pika e fundit: Shqyrtimi i projektvendimit për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për në Formimin Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, për kandidatin: {...}, relator z. Ilir Toska.

Atëherë, sipas radhës, vijojmë me çështjen e parë. Relator zoti Toska.

Faleminderit! Fjala për ju!

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, nga Gjykata e Lartë, ditën e djeshme ka mbërritur një kërkesë që përmban 5 çështje që kanë të bëjnë me ekstradimin, për të cilat kërkohet 4 gjyqtarë për gjykimin e këtyre çështjeve.

Në këtë rast, zbatimi i mekanizmit të caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, nga nevoja si më lart e Gjykatës së Lartë, duke u bërë i nevojshëm zbatimi i këtij vendimi të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në konsideratë të kriterëve të përcaktuara në paragrafin X/1 të vendimit si më sipër të Këshillit të Lartë Gjyqësor, por edhe referuar përcaktimeve të shkronjës “c”, pika 5, Kreu IV, të këtij vendimi, në zbatim të paragrafit VI, pika 4, të tij, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 5 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm dhe Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda.

Gjyqtarët për 5 çështjet gjyqësore të veçanta, të përzgjidhen, me short, ndërmyjet atyre të cilët kanë të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 5 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 4.

Në rast të pranimit të propozimit si më lart, për hapat e shortit, Komisioni i propozon që, për 5 çështjet, për të cilat kërkohet caktimi i 4 gjyqtarëve, ata të përzgjidhen, me short, ndërmjet gjyqtarëve të apelit që plotësojnë kriteret si më lart. Në rast se nga shorti përzgjidhet gjyqtari {...} i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, atëherë për çështjen nr. 2, në të cilën ai ka pengesë ligjore për gjykimin e saj, për gjyqtarin e katërt, të zhvillohet short për përzgjedhjen e tij nga gjyqtarët e tjerë që plotësojnë kriteret.

Gjyqtarët që plotësojnë kriteret e përmendura më lart nga gjykatat e apeleve me juridiksion të përgjithshëm dhe Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda janë: {...} ... {...}.
Jeni dakord me këtë propozim?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Mirë atëherë, meqenëse Këshilli ra dakord me propozimet e Komisionit, do të zhvillojmë procedurat e shortit për 5 çështjet në nevojë në Gjykatën e Lartë.

Do marrësh një enë dhe do të fusësh emrat e gjyqtarëve që plotësojnë kriteret, pra: {...} ... {...}; dhe do të përzgjedhim 4 prej tyre.

Valbona Bako: {...} ... {...}.

Ilir Toska: Mirë atëherë, futëm në një enë emrat e gjyqtarëve. Tani do t'i përziejmë dhe do të përzgjedhim 4 prej tyre.

Atëherë, emri i parë i përzgjedhur është {...}.

Emri i dytë është {...}.

Emri i tretë është {...}.

Emri i katërt është {...}.

Këta janë gjyqtarët e përzgjedhur (4 gjyqtarët).

Atëherë, për shkak se nga shorti u përzgjedh edhe gjyqtari {...}, për çështjen nr. 2 do të duhet të zhvillojmë short mes gjyqtarëve të tjerë, për të përzgjedhur gjyqtarin e katërt për çështjen nr. 2.

Nga ata duhet të përzgjedhim njërin.

Atëherë, për çështjen nr. 2 gjyqtari i katërt i përzgjedhur është gjyqtari {...}. Me kaq mbyllen procedurat e shortit.

Maksim Qoku: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, siç u mor dijëni nga shorti, u përcaktuan 4 gjyqtarët.

Pa lexuar projektvendimin, thjesht pika e fundit që, një kopje e vendimit do t'i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit, zoti Toska!

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 17.10.2019)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Miratimi i projektvendimit “Për ndryshimin e vendimit nr. 211, datë 11.10.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për caktim gjyqtari, në një çështje gjyqësore të veçantë, në Gjykatën e Apelit Durrës””.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:20 dhe mbaroi në orën 11:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
2. ***Medi Bici*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
5. ***Ilir Toska*** (anëtar)
6. ***Alban Toro*** (anëtar)
7. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
8. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje ***zonja Naureda Llagami***, Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***zoti Erjon Muharremaj***, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor si dhe ***zonja Brunilda Kadi***, anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
4. *Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
5. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
6. *Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
7. *Arlind Maloku, Qendra Evropiane.*
8. *Ervin Karamuço, ISP.*
9. *Julinda Beqiraj, EURALIUS.*
10. *Klodian Rado, EURALIUS.*
11. *Valbona Bala, USAID.*
12. *Gregor Borkowski, EURALIUS.*
13. *Chuck Ericksen, USAID.*
14. *Tahir Lamçe, OSCE.*

RENDI I DITËS:

2. Miratimi i projektvendimit “Për ndryshimin e vendimit nr. 211, datë 11.10.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për caktim gjyqtari, në një çështje gjyqësore të veçantë, në Gjykatën e Apelit Durrës””.

Maksim Qoku: Vazhdojmë me çështjen e dytë. Çështja e dytë që ka të bëjë me miratimin e projektvendimit “Për ndryshimin e vendimit nr. 211, datë 11.10.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për caktim gjyqtari, në Gjykatën e Apelit Durrës””.

Fjala për ju, zoti Toska!

Faleminderit!

Ilir Toska: Mirë atëherë, edhe për këtë çështje kemi përgatitur një relacion. Po ju parashtroj rrethanat e faktit.

Mbi kërkesën nr. 782/2 prot., datë 17.09.2019, të kryetarit të Gjykatës së Apelit Durrës, për caktim gjyqtari për gjykimin një çështjeje gjyqësore të veçantë, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka shqyrtuar këtë kërkesë.

Në këtë rast, për kërkesën si më lart të Gjykatës së Apelit Durrës, në pamundësi të zbatimit të mekanizmit të skemës së delegimit dhe padobishmërisë së zbatimit të mekanizmit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, Komisionit i Zhvillimit të Karrierës i ka propozuar Këshillit të Lartë Gjyqësor zbatimin e vendimit “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Më konkretisht, në konsideratë të kriterëve të përcaktuara në paragrafin IV, pika 5, të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më lart, si dhe në zbatim të paragrafit VI, pika 4, të këtij vendimi, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i ka propozuar më herët Këshillit të Lartë Gjyqësor që gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, ndërsa numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Propozimi i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës është pranuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, ku mbi këtë bazë është zhvilluar procedura e shortit, për përzgjedhjen e 1 gjyqtari të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, për 1 çështje gjyqësore të veçantë, për të cilën kërkohej caktimi i 1 gjyqtari.

Në këtë rast, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka pranuar edhe propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës për përjashtimin nga shorti të kryetares në detyrë të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, {...}, si dhe të gjyqtarëve të kësaj gjykate që do të caktoheshin për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Apelit Gjirokastër.

Për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, nga shorti janë përzgjedhur gjyqtarët {...}, {...} dhe {...}.

Më tej, përmes shortit, për çështjen e identifikuar në nevojë në Gjykatën e Apelit Durrës, është zhvilluar mes gjyqtarëve {...} dhe {...} dhe ky i fundit është përzgjedhur.

Mbi këtë bazë, me vendimin nr. 211, datë 11.10.2019, paragrafi I, nënndarja “Gjykata e Apelit Durrës”, pika 1, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka vendosur: “1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës, çështjen gjyqësore me kërkues: Shoqëria “Ushina” sh.p.k.; persona të interesuar: Shoqëria “Rekon”, {...}, {...}; me objekt: “Pushimi i çështjes penale”.

Mbas njoftimit të këtij vendimi, kancelarja e Gjykatës së Apelit Durrës, përmes e-mailit të datës 16.10.2019, i ka bërë me dije Këshillit të Lartë Gjyqësor se sa i përkiste caktimit të gjyqtarit {...} për gjykimin e çështjes penale si më lart, Këshilli nuk kishte mbajtur parasysh se ky gjyqtar ishte caktuar më herët prej tij (me vendimin nr.199, datë 11.09.2019)

Nga shqyrtimi i materialeve, pikërisht të kërkesës datë 17.09.2019, të kryetarit të Gjykatës së Apelit Durrës, rezulton të jetë bërë prezent fakti se për çështjen penale si më lart kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ndërsa trupi gjykues formohet vetëm nga dy gjyqtarë, konkretisht gjyqtarët {...} dhe {...} të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda.

Një rrethane e tillë, pra qenia i caktuar më herët për gjykimin e çështjes penale në fjalë të gjyqtarit {...}, rezulton të mos jetë mbajtur parasysh nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në marrjen e vendimit nr. 211, datë 11.10.2019, paragrafi I, nënndarja “Gjykata e Apelit Durrës”, pika 1, përmes të cilit gjyqtari {...} është caktuar përsëri për gjykimin e të njëjtës çështje penale.

Në këto kushte, bazuar në nenet 113 dhe 117 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në nenin 99 të ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, është vendi për ndryshimin e pikës 1, nënndarja “Gjykata e Apelit Durrës”, paragrafit I, të vendimit nr. 211, datë 11.10.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sa i përket gjyqtarit të caktuar për gjykimin e çështjes penale si më lart.

Lidhur me gjyqtarin që duhet të caktohet për gjykimin e asaj çështje gjyqësore të veçantë, duke konsideruar propozimet e pranuar në mbledhjen e datës 11.10.2019, sa i përket gjykatës nga duhet të caktohet gjyqtari, pra Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, si dhe sa i përket gjyqtarëve të kësaj gjykate që përjashtohen nga shorti, pra gjyqtarët {...} ... {...}, që janë caktuar në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, si dhe duke patur parasysh gjyqtarët në detyrë të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, mbetet që për gjykimin e

kësaj çështjeje penale në nevojë të Gjykatës së Apelit Durrës, gjyqtari që duhet të caktohet, të jetë praktikisht i përzgjedhur nga shorti, pikërisht gjyqtari {...}.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon: Ndryshimin e pikës 1, nënndarja “Gjykata e Apelit Durrës”, paragrafi I, të vendimit nr. 211, datë 11.10.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në këtë mënyrë: “1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës, çështjen gjyqësore me kërkues: Shoqëria “Ushina” sh.p.k; persona të interesuar: Shoqëria “Rekon”, {...}, {...}; me objekt: “Pushimi i çështjes penale”. Ky është edhe propozimi i Komisionit.

Maksim Qoku: Faleminderit, zoti Toska!

Nëse ka nga anëtarët për të shtuar apo në lidhje me... Kalojmë në votim!

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Maksim Qoku: Dakord.

Atëherë, një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarit përkatës të caktuar për gjykimin e çështjes. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor